



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 598/7 Prot.

Tiranë, më 13.042023

VENDIM

Nr. 6/3, datë 13.042023

“PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 6, DATË 24.02.2023 TË INSPEKTORIT TË  
LARTË TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INSPEKTIMEVE  
PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja “dh”, “ë” dhe “k”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 6, datë 24.02.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2023”,

VENDOSA:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 6, datë 24.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2023”, ndryshohet me lidhjen nr. 1/1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Njësia e Inspektorëve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



**Lidhja nr. 1/1. Plani i inspektimeve për vitin 2023**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i inspektimit</b>	<b>Objekti i inspektimit</b>	<b>Periudha e realizimit të inspektimit</b>	<b>Organi i inspektuar</b>	<b>Afati i dorëzimit të raportit të inspektimit</b>
1.	Tematik	Ndarja e çështjeve me short, si edhe kontroll të raporteve të sistemit elektronik në gjykata për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022	01.03.2023 – 15.09.2023	Gjykatat që do të përzgjidhen në vendimin e inspektimit.	15.09.2023
2.	Tematik	Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022	01.07.2023 – 29.12.2023	Prokuroritë që do të përzgjidhen në vendimin e inspektimit.	29.12.2023
3.	Tematik	Mbi caktimin e çështjeve në prokurori për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022	01.03.2023 – 15.09.2023	Prokuroritë që do të përzgjidhen në vendimin e inspektimit.	15.09.2023
4.	Tematik	Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Civile; dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për periudhën 01.09.2022 – 30.12.2022	13.04.2023 – 17.07.2023	Gjykatat që do të përzgjidhen në vendimin e inspektimit.	17.07.2023